Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ibadete Guri	**16.09.2024**	**27.09.2024**	**2024/0813**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.09.2024, OE "Crazy Pet SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0813, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-s për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "GOE-ve Klinka Veterinare –Pet O.P ; Haki Bytyqi B.I –Prishtinë.Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "SHËRBIME VETERINARE" me nr. të prokurimit: "214-24-5514-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar : Procedurën e hapur, shërbim,vlera e parashikuar e kontratës- 58,360.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat që janë shkeluar nga AK:

Ligji Nr. 04/L042 i Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, Ligjit 05/L092

Nenet e shkeluar nga AK:

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi;
Neni 7 i LPP-së- Barazia në trjatim/ Jo – Diskriminimi;
Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,
Neni 41.1 i RrOUP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Opinioni i KRPP për kontrata te njëjta apo te ngjajshme.
Udhëzuesi për Prokurim Publik 001/2023, pika 10.1

Ne edhe për kundër faktit që kemi njoftuar AK për shkeljet kërkesa jonë është refuzuar, andaj ne po shfrytëzojmë te drejtën tonë për ankesë në OSHP.

Pretendimet tonat bazuara në LPP janë:

është shkelur neni 1- Qëllimi, duke mos ofruar transparencë sic, e para shehë ky nenë citoj: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë

[redacted]

ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

OE ka berë manipulime me cmime si:
PIKA 5: Cmimi është spekulativ dhe nuk përfshin analizat biokimike me të gjithë parametrat e nevojshëm. Vlera është e përcaktuar në 5 euro.
PIKA 12: Cmimi është spekulativ dhe nuk është e mundur që një ndërhyrje kirurgjikale për trajtimin e një tumori, që varion nga madhësia 1 mm deri në përmasa të papërcaktuara, të kushtojë vetëm 30 euro, sidomos kur përfshihet trajtimi i plotë i tumorit.
PIKA 14: Kollaret kundër parazitëve që përmbajnë deltametrinë dhe që quhen Scaliobor sipas fituesit të deklaruar, nuk ekzistojnë askund në tregun botëror me cmimin prej 5 euro. Ky cmim është spekulativ dhe me këtë vlerë këto kollare nuk do t'u ofrohen qenve (K9).
PIKA 22: Cmimi për ID elektronike (cipi) dhe librezën është spekulativ, sepse vetëm blerja e të dyjave në Odën Veterinare kushton 5 euro. (**shih vendimin e bashkangjitur, në këtë cmimore është përcaktuar cmimi më i ulët i shërbimeve, shërbimet pas orarit janë 50% më të shrenjta). Ndersa, OE i rekomanduar për kontrata ka ofruar cmime dukshem me te ulëta, duke shkelur këtë vendim dhe duke prishur cmimet e tregut.**

PIKA 23: Cmimi është spekulativ për tregun, pasi nuk ekziston qethje e qenit me cmimin prej 2 eurosh. Ky operator ekonomik ka prishur cmimet e tregut, duke mos respektuar cmimet e përcaktuara nga institucionet përkatëse sic është Oda e Veterinarisë se Kosovës.

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform **nenit 87, paragrafit 2, në paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:**

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemer që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Duke e ditur se ky tender është për shërbime veterinere për qenët zyrtar te policisë së Kosovës. **Grupi i Operatoreve Ekonomik (GOE)** nuk përmbush kriterin e dosjes se tenderit për kontratat e realizuara, duke qenë se:

Deshmia e kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë listën e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit, të nënshkruara dhe te vulosura nga OE, të shoqëruara me referenca ose fletë ranime të nënshkruara dhe vulosura nga autoritetet përkatëse. Këto dokumente duhet të përmbajnë numrin e prokuristi ose kontratës, vlerën, datën e nënshkrimit dhe vendin e realizimit, me vlerë minimale prej 50,000 euro Euro. **Nëse mungojnë këto elemente, kontrata nuk do të llogaritet.**

Në listën e kontratave te realizuara mungon: nr i prokurimit ose kontratës, data e nënshkrimit. **Atëherë në bazë të udhëzuesit nr. 001/2023 për prokurim publik pikës 10.1 Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar. AK duhet te Refuzoj tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Si dhe vetë kërkesës se AK-se neëse mungojnë këto elemente, kontrata nuk do të llogaritet.**

Referencat dhe kontratat tjera: Referenca nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarise" pe"r OE M & N – I SH.P.K.; Haki Bytyc,i B.I., tregon se është realizuar një kontratë për Shërbime Veterinare në terren - Lot 13 - Komuna Istog, me vlerë 60,000.00 euro nga 19/09/2019 deri më 18/09/2022. Operatori Haki Bytyc,i B.I. **ka realizuar 50% të shërbimeve të kësaj kontrate, që nuk arrin vlerën minimale prej 50,000.00 euro të kërkuar. Sipas AK-së kjo është verifikuar pas kërkesës sonë për rishqyrtim por nga dosja e tenderit me nr prokurimit** 40800/19/003-1186/215, Titulli: **Shërbimet veterinare në terren, ne lot 13- Komuna Istog nuk ka shërbime për qenë pra nuk ka shërbime te njëjta e as te ngjajshme dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Shih specifikimin teknik te kësaj dosje.**

Loti 13. KOMUNA E ISTOGUT (fondi i kafshëve mbi 20 000 krerë)

Kategoria 3

Nxjerrja e gjakut tek kafshët e imëta(delet,dhitë,dhe derrat) marrja e mostrave te gjakut tek shpezët
Nxjerrja e gjakut tek gjedhet

Testi i TBC

Vaksinimi i deleve dhe dhive kundër sëmundjes se Brucelozës

Vaksinimi i derrave kundër Mortajës Klasike

Vaksinimi emergjent tek gjedhet

Vaksinimi emergjent tel delet, dhite dhe derrat

Identifikimi dhe regjistrimi i gjedheve

Identifikimi dhe regjistrimi i deleve dhe dhive

Identifikimi dhe regjistrimi i derrave

Vaksinimi i gjedheve kundër Sëmundjes Gungore (LSD-së).

Pra, AK ka pranuar dëshmi që nuk i përmbushin kërkesat e veta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional** **a) OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit jo me pak se 50,000.00 €**	**Dëshmia e kërkuar dokumentare:** **a)Dëshmia Operatori Ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të projektit, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuar të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë min 50,000.00 €** **Vërejtje: Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e flete pranimeve të shërbimeve, kur shërbimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES
Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: SHËRBIME VETERINARE	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik KLINIKA VETERINARE KING - PET O.P.; Haki Bytyçi B.I.,	44,240.00
2.	"Crazy Pet" SH.P.K., 601682695	58,145.00

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur 6

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	SHËRBIME VETERINARE		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik KLINIKA VETERINARE KING - PET O.P.; Haki Bytyçi B.I.	10000	Fehmi Agani 161

DEKLARATË

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte pale me interes sipas nenit Nenit 4.1.26 te LPP-s

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Crazy Pet" SH.P.K.**

Përgjigje në pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme ankesen duke i trajtuar te gjitha pretendimet ankimore dhe ate :

Pretendimi ankimor 1– Në këtë pretendime OE ankues pretendon se AK-ja ka shkelur nenin 1 - Qellimin te LPP-s ,pasi që pretendon se GOE-ve i rekomanduar me dhënie të kontrates ka ofruar cmime manipulative për pozicionet :

Poz.5 - Analizat e gjakut (biokimike dhe hematologjike)sipas nevojës – 5 Euro

Poz.12 - Largimi i tumoreve te ndryshëm me ane te intervenimit kirurgjikal si dhe terapija deri ne mjekim përfundimtar dhe anestezioni – 30 Euro

Poz.14 - Kollare kundër parazitëve (delta metri n 1 gram)45 cm- 65 cm 2 her ne vit - 10 Euro

Poz.22 - ID Elektronik (qipi) për qen zyrtar –dhe libreza e RKS – 1 Euro

Poz.23- Qethja e qenit – 2 Euro.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin lartëshënuar: Pa hyre në ndonjë analizë të hollsishme të këtij pretendimi ankimore ,bazuar në pikën 41.1 të nenit 41 te Rregullores për Prokurim Publik, ku koncepti i tenderve jo- nomalisht të ulët i referohet tenderëve që për **Autoritetin Kontraktues** në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës dhe nëse këto cmime për Autoritetin Kontraktues janë cmime të pranueshme atëher mbetet në pergjegjesi të vet Autoritetit Kontraktues që kontrata të

implementohet në harmoni me kushtet e kontraktuara .

Bazuar në pike 41.1 të nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik , pretendimi ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 2 - Ne kete pretendime ankimore ,OE akues pretendon se AK-ja ka shkelur nenin e 59 te LPP-s pasi qa ka rekomanduar qe te shperblehet me kontrate GOE-ve ti cilat nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesa e kërkuara nga vet AK-ja ,duke pretenduar se GOE-ve nuk ka plotesuar kriterin per kontratat e realizuara sipas kerkesen se nenit 69 , kerkesen :Kapaciteti teknik dhe profesionala) OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit jo me pak se 50,000.00 €.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin lartëshënuar: Eksperti shqyrtues, sqaron se pas shqyrtimit të pretendimit ankimore, analizimit fakteve dhe argumenteve , bazur ne Ligjin per Prokurim Publik nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,Autoriteti Kontraktues ka vlersuar ne harmoni me nenin e lartcekur pasi qe duke u thirru ne keto argumente:

Lista e kontratave e dorezuar ploteson kerkesen e AK-s dhe eshte mbi vleren minimale te kerkuara ,pasi qe kontratat e realizuara disa jane te njejta e disa jane te ngjajshme me natyren e kerkuar,ashtu siq edhe eshte kerkesa e AK-s e vendosur ne DT dhe ne Njoftimin per Kontrate si :

Trajtimi.kastrimi dhe sterilizimi i qenve endacak – vlersohet se eshte e **njejt** me natyren e aktivitetit kontraktues .

Dezinfektimi i hapsirave publike; Dezinfektimi ,dezinsektimi dhe deratizimi ne institucionet komunale –vlersohet qe jane natyre e **ngjajshme** me natyren e aktivitetit ,pasi qe ne paramas dhe parallogari te publikura nga AK-ja, keto pozicione te ngjashme me ato te kerkuar ne pozicionet 1 dhe 2 te kesaj paramase se publikuar per keet aktivitet nga AK-Policija e Kosoves .

Sherbimet veterinare per gjedhe dhe qene ne Q.K Dubrav – vlersohet se eshte e **njejt** me natyren e aktivitetit te prokurimit dhe

Po ashtu kontrata Sherbimet veterinare ne terren-Lot 13 Komuna e Istogut ,ku edhe kjo kontrate eshte kontestimi thelbesor nga ana e OE ankues – kjo kontrate vlersohet se eshte e **ngjajshme** me natyren e aktivitetit pasi qe edhe vet aktiviteti i publikuar nga AK - Policija e Kosoves mban titulllin Sherbime Veterinare .Vetem sa per ilustrim po e paraqes listen e kontrates te ciles ju kam referuar .

HAKI BYTYÇI B.I.

Lista e kontrave të realizuara (projekte të ngjashme)

Titulli i projektit	Vlera projektit	Kontraktori	Data e perfundimit
Trajtimi,kastrimi dhe sterilizimi i qenve endacak	24,634.00 €	Komuna Istog	01.01.2023
Dezinfektimi i hapesirave publike	13,255.00 €	Komuna Istog	23.10.2021
Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi ne institucionet komunale	3,139.20 €	Komuna Istog	2023
Sherbime veterinare per gjedhe dhe qene ne Q.K Dubrave	15,000.00 €	Sherbimi Korrektues i Kosovës	20.11.2022
Sherbimet veterinare ne terren - Lot 13 Komuna Istog	60,000.00 €	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	18.09.2022
Totali i vlerës	**116,028.20 €**		

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron i pa bazuar pretendimi ankimor i lartcekura nga OE ankues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Crazy Pet" SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Ibadete Guri